




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në seancën e **III (e tretë)** të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, më datë 15.3.2013 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Propozim-projekti për themelimin e Muzeut të Komunës

2. Propozim –vendimi për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për studentë të dalluar

3. Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për studentë të dalluar

4. Propozim vendimi për emërimin e Komisionit për përcaktimin e listës së lokacioneve dhe hapësirave publike për vendosjen e Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve dhe Simboleve, brenda territorit të Komunës së Gjiçanit,

5. Propozim vendimi për emërimin e Këshillit Komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjiçanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë,

3. Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Në punimet e seancës së dytë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit,

Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa,

Drejtorët e drejtorive

Përfaqësuesi i OSB-së, z. Basri Sejdiu
Përfaqësuesi i OJQ "Anamorava", z. Isa Shefkiu
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu
Mediet

Seancën e tretë të KK-së e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, përfaqësuesit e OSB-së dhe të gjithë drejtorët e drejtorive, duke i përfshirë edhe monitoruesit e tjerë të cilët i përcjellin punimet KK-së.

Në vijim kryesuesi kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve KK-së në punimet e seancës së tretë.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Pas verifikimit që e bëri sekretaria u konstatua se në punimet e seancës së tretë ishin të pranishëm 36 anëtarë të Kuvendit, kurse munguan 5 anëtarë: Sabedin Kadriu, Tahir Arifi, Ejup Haziri, Arben Maliqi, Selim Selimi.

Izmi Zeka- rendin e punës e keni marrë me kohë qysh nga seanca e kaluar, sepse për shkak të numrit voluminoz të pikëve, nga ana e anëtarëve të Kuvendit, u kërkua që të seanca e dytë të ndahet në dy seanca. Për këtë seancë i kemi 5 pika të rendit të punës, prandaj së pari fjalën e keni ju.

Sokol Haziri- së pari më lejoni që Degës së PDK-së në Gjilan t'ia uroj kryesinë e re dhe t'ia uroj sukses dhe rezultate sa më të mira në punë.

Lidhur me rendin e punës me siguri në seancën e kaluar kemi propozuar që të rishqyrtohen vendimet lidhur me kushtëzimin qytetarëve për pagesën e ujit dhe të mbeturinave. Ju patët deklaruar, z. Kryesues se në këtë seancë do ta shqyrtojmë këtë çështje dhe për të njëjtën do të vendosim sot. Unë në rend të ditës nuk po e shoh këtë çështje, prandaj është mirë qysh sot këtë çështje ta rishqyrtojmë dhe të marrim vendim për heqje të kushtëzimit, sepse kemi konsideruar dhe konsiderojmë se ky vendim është një ndër aktet më të paligjshme që ka nxjerr ky Kuvend dhe nuk është në interes të qytetarëve. Komuna nuk mund të jetë në shërbim të kompanive, sepse ato e kanë menaxhmentin e tyre, i kanë bordet e tyre dhe ne si KK nuk kemi asnjë ingerencë për t'ua marrë me këtë çështje.

Lidhur me këtë çështje disa qytetarë iu janë drejtuar edhe Avokatit të Popullit, përkatësisht kësaj zyre në Gjilan, por ne konsiderojmë që me vetë faktin, se Avokati i Popullit është i pranishëm në lokalet e selisë së kryetarit, është një konflikt i thellë i interesit në mes institucionit të kryetarit të Komunës, Ekzekutivit dhe Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit është për t'ia mbrojtur interesat dhe të drejtat e popullit kur shkelen nga institucionet e Komunës dhe në asnjë mënyrë nuk janë aty kur i shkelen Komunës të drejtat në mbrojtje nga qytetarët. Unë mendoj se duhet me urgjencë koalicioni Qeverisës që është ta shqyrtojë këtë çështje dhe ata të largohen prej atij objekti. Këtë po e them se Avokati i Popullit nuk është përgjigj një grupi të qytetarëve lidhur me ligjshmërinë e kushtëzimit që i kemi bërë qytetarëve lidhur me pagesën e ujit dhe të mbeturinave.

E treta është çështja e këshillave, nëpër bashkësi lokale dhe vendbanimeve i cili është një proces i hershëm dhe ka kaluar shumë kohë, por i njëjti nuk po funksionon. Unë kërkoj që në një nga takimet e radhës me shefat e grupeve ta trajtojmë këtë çështje në mënyrë meritore dhe të hyjmë në këtë proces.

Sadudin Berisha- rreth kësaj që e tha parafolësi të cilat ne i kemi theksuar në seancat e mëparshme, por vërtetë duhet formalizuar vendimin për shfuqizimin e kushtëzimeve tash e një vit të miratuar.

Së dyti grupi i LDK-së ka kërkuar ditë më parë, por edhe në seancën e fundit të KK-së që të ofrohet një informatë e detajuar nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme për tollovinë e cila po bëhet para Administratës së Përgjithshme e që shihet para hyrje së objektit të Administratës së Komunës së Gjilanit. Kemi raste të shumta që njerëzit janë duke pritur nga 3-4 orë për një dokument të vetëm Gjatë pritjeve të gjata ka pasur raste që qytetarët janë alivanosur dhe në këto kushte atmosferike është e patolerueshme një sjellje e tillë. Është për çudi se DA na e ka përcjell një informatë, por është pamjaftueshme për të dhënë një përgjigje të drejtë rreth këtij problemi. Kërkojmë që në kuadër të pikës të ndryshme të jetë një informatë më e detajuar dhe të shihet mënyra e daljes nga kjo situatë, sepse kjo është një papërgjegjësi e madhe që sot nuk është i pranishëm në këtë seancë drejtori i AP, kur kemi kërkuar që kjo çështje të trajtohet në KK dhe të gjendet zgjidhje për këtë çështje.

Bahrie Veseli- së pari po e paraqes në shqetësim, sepse tavolinat tona qenkan shumë të papastra, kurse neve po na duhet me duart tona ta fshijmë pluhurin, sepse që nga seanca e kaluar kanë mbetur ashtu.

Kërkesë tjetër e imja është ajo për një kioskë e cila është vendosur pranë Shkollës Fillore “Abaz Ajeti” për të cilën kërkoj që ta di se a ka leje dhe kush e ka dhënë atë leje nëse ka leje? Më parë aty ka qenë një kioskë e cila ka qenë më parë gjithmonë e ka penguar procesin mësimor dhe ka ndikuar keq në mirëmbajtjen e ambientit shkollor. Gjithashtu kërkojmë një informatë për veturat zyrtare të cilat po keqpërdoren, sepse po përdoren për punë private e sidomos nga Drejtoria për Shërbime Publike, sepse vetura e tyre çdo ditë i bartë punëtorët dhe familjarët e vetë!

Arianit Sllamniku- unë do t’ i ngrit dy çështje: e para ka të bëjë me informatën e cila na ka ardhur na Administrata për shkaktimin e kaosit pranë kësaj administrate.

Këtë problematik e kam paralajmëruar me 2 korrik të vitit 2012 përmes shkrimeve të mia.

Mirëpo drejtori i Administratës me këtë informatë po mundohet për ta arsyetuar dështimin e tij dhe dështimin e ekzekutivit. Ky ekzekutiv ka të bëjë edhe me mospërmbushjen e vendimeve të gjykatës siç është rasti i Agim Velekicës i cili ende nuk është kthyer në vendin e punës edhe pse e ka një vendim nga gjykata.

Çështje e tretë ka të bëjë me vendosjen e taksistëve të cilët janë larguar aty afër Hotelit ku po bëhen punët për rregullimin e Lumit Mirusha. Ata taksitë që kanë qenë aty, tash nuk janë të sistemuar askund dhe dalin kudo që mund ta gjejnë ndonjë hapësirë.

Është mirë që të merret parasysh ky fakt dhe t’ i sigurohet një lokacion i ri këtyre taksistëve.

Izmi Zeka- e kuptoj se këtu është TV “Vali”, mandej janë radiot, por duhet ta keni parasysh që kjo është vazhdim i seancës së kaluar kemi debatuar për rendin e punës dhe e kemi ndarë në dy seanca dhe rendi i punës është ky.

Çështjet tjera unë e kam thënë në seancën e kaluar se në seancën e ardhme do ta kemi një debat rreth kushtëzimeve. Kjo do të jetë në rend të punës dhe për këtë do të vendos Kuvendi. Një informatë nga DA e keni marrë dhe nëse vjen drejtori i Administratës do ta jep edhe një informatë zyrtare para anëtarëve të Kuvendit.

Duhet llogaritur se sot nuk do ta fusim asnjë pikë të rendit të punës, sepse ashtu jemi marrë vesh. Çështja e kisoskut të “Abaz Ajeti” do të definohet, por unë nuk kam informacion të saktë, prandaj duhet informatë të japin ata që e kanë lejuar.

Iu kisha lut që mos ta shndërrojmë Kuvendin në fushatë parazgjedhore, sepse këtu jemi në institucion, kurse për fushatë e kemi vendin tjetër kund.

Sokol Haziri- më duket se kryesuesi po e tepron me komente lidhur me atë se çka mendoj unë dhe çka mendon tjetri. Secila e ka dike që e përfaqëson dhe e ka autoritetin vetë dhe nuk është mirë fjalët tona të cilësohen si fushatë para zgjedhore as pas zgjedhore, sepse ne nuk e dimë se ka shpall dikush fushatë parazgjedhore dhe ende nuk është caktuar data e zgjedhjeve as lokale as qendrore. Për këtë arsyeje nuk është mirë të përdoret zhargoni i fushatës, por unë nuk flasë për prani të televizionit, por flas sipas bindjeve të mia dhe ajo për çka është në interes të qytetarëve.

Unë dëshiroj që të marrë një përgjigje nga ju ose nga Kuvendi që nëse jo sot që ta konfirmoni atë që e keni thënë vetë se do ta shtroni si çështje në takimin e radhës çështjen e kushtëzimeve. Nëse ndodh ashtu unë pajtohem, por herëve të tjera unë kërkoj që propozimet e mia të vihen në votim në Kuvend. Kuvendi është autoriteti i cili vendos me shumicë votash me një propozim nga një grup politik apo anëtarë të Kuvendit. Nëse e konfirmoni edhe njëherë se jeni të gatshëm ta vendosni në shqyrtim këtë çështje në seancën e radhës unë pajtohem, sepse kjo vërtetë ka zgjatur shumë.

Sadudin Berisha- kur shprehet një dukuri në çdo seancë, nga seanca në seancë, kryesuesi i jep komentet dhe i refuzon për pa e pyetur Kuvendin a është apo jo për një propozim të caktuar. Këtë rast i kish dy çështje për t’i shtruar: çështjen e diskutimit dhe shfuqizimit të asaj që ne si opozitë i kemi pasur që nga fillimi lidhur me kushtëzimin dhe në anën tjetër atë të diskutimit dhe të informatës për tollovinë që po shkaktohet para Administratës Komunale e cila informatë nuk pret asnjë orë.

Njerëzit presin nga tri-katër orë dhe nuk ka zgjidhje, alivanosen duke pritur dhe në këtë mënyrë maltretohen duke pritur ndonjë numër të radhës.

Për këtë arsyeje kujtoj se ky propozim duhet të hidhet në votim dhe a vendoset për debat sot, apo në ndonjë seancë të ardhme vendosin anëtarët e Kuvendit. Për këtë arsyeje të dy propozimet duhet të hidhen në votim.

Izmi Zeka- në seancën e kaluar seancën e kemi ndarë në dy pjesë, sot debatohen pikat të cilat i kemi ndarë për këtë seancë. Unë po iu them se një debat do të hapet për kushtëzimet, një informatë zyrtare do ta jep drejtori i AP-së në fund të punimeve të kësaj seance.

Bahrie Veseli – ne i kemi dorëzuar disa kërkesa me shkrim, por ende nuk kemi marrë përgjigje, prandaj iu lus që të na epni përgjigje?

Izmi Zeka- kërkesat të cilat janë bërë me shkrim e kanë për obligim drejtoritë t'iu japin përgjigje. Drejtoritë janë të obliguara t'iu kthejnë përgjigje ashtu si iu keni drejtuar. Është mirë të na informoni se cila drejtori nuk iu ka kthyer përgjigje?

Ju lutem kush është për këtë rend të punës duke ia shtuar rendit të punës edhe informatën nga drejtori AP-së?

Aprovohet rendi i punës me vota të gjithë anëtarëve të Kuvendit

Abdyl Aliu- e kam një vërejtje, sepse e kemi tejkaluar rendin e punës dhe nuk e kemi aprovuar rendin e punës. Unë personalisht nuk kam vërejtje, por është në rend të punës dhe procesverbal i seancës së kaluar duhet të votohet.

Izmi Zeka- a ka ndonjë vërejtje në procesverbal nga seanca e kaluar?

Nuk pati vërejte në procesverbal dhe u miratua pa vërejtje.

1. Propozim-projekti për themelimin e Muzeut të Komunës

Izmi Zeka- përkitazi me këtë propozim, arsyetim do ta jep drejtori i DKRS-së, z. Veton Nevzadi.

Veton Nevzadi- iu përshëndes të gjithëve dhe më lejoni që para juve të paraqes projektin ideor për themelimin Muzeut Rajonal të Gjilanit për të cilin projekt kryetari i Komunës me datën 27.4.2012 ka themeluar Komisionin komunal për hartimin e projektit ideor për themelimin e Muzeut Rajonal të Gjilanit.

Ky komision është i përbërë prej 6 anëtarëve me një konsulentë shkencore nga prof.dr. Jahja Dranqolli i cili është profesor i artit në Universitetin e Prishtinës.

Është e njohur se Gjilani ka dy institucione rajonale të cilat merren me trashëgiminë shpirtërore dhe materiale, do të thotë Arikivi Rajonal i cili merret me trashëgiminë materiale dhe Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë e cila merret me trashëgimi shpirtërore. Ky komisioni e ka hartuar projektin ideor për Muzeun Rajonal të Gjilanit dhe ne i kemi kaluar të gjitha fazat të cilat kanë qenë të nevojshme, do të thotë në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në Komitetin për Financa, kurse tash para juve tash e kemi paraqit projektin ideor të cilin kërkojmë që ta aprovoni.

Gjilani i ka mbi 200 artifakte të cilat mund të ruhen në Muze, por ne mendojmë se Gjilani ka edhe më tepër artifakte të cilat duhet të ruhen.

Ne para juve e kemi paraqit edhe kuadrin të cilin duhet ta ketë ky Muze, por i kemi shqyrtuar edhe objektet ku mund të vendoset ky Muze siç është Shkolla e Muzikës, Selia e LDK-së, etj. Ne si Kuvend mendoj se duhet t'iu japim përkrahje këtij projekti dhe sa më shpejtë të krijojmë kushte për themelimin të këtij Muzeu.

Shkëlqim Latifi- i përshëndes të gjithë, por posaçërisht drejtorin e Kulturës për një propozim të tillë për themelimin e Muzeut Rajonal të Gjilanit. Unë mendoj se drejtori e ka sjell një kërkesë shumë të arsyeshme, por e përshëndes dhe e falënderoj edhe grupin punues i cili e ka bërë një punë shumë të mirë.

Unë mendoj se Gjilanit i ka munguar një Muze i tillë dhe ke qenë e nevojshme edhe më herët të merret një nismë e tillë.

Mirëpo një kërkesë të tillë e kam paraqit edhe para 4 viteve përmes medieve, por mendoj se edhe tash nuk është vonë. Unë edhe njëherë e përshëndes drejtorin dhe njëkohësisht dhe i ftoj të gjithë kolegët në Kuvend që pa rezervë ta mbështesin themelimin e këtij Muzeu, sepse kemi nevojë. Kemi shumë eksponate të cilat Qendra për Trashëgimi Kulturorë është duke i ruajtur në vende jo të përshtatshme, prandaj për këtë arsyeje është e nevojshme që të themelohet Muzeu dhe të eksponohen të gjitha ato vlera kulturore materiale që i ka Gjilani me rrethinë. Mirëpo ne duhet ta mbështesim edhe Muzeun, por duhet të mendojmë dhe shikojmë edhe më larg dhe edhe materialisht ta mbështesim Qendrën e Trashëgimisë Kulturorë, sepse kemi shumë lokalitete të ndryshme të cilat kanë vlera kulturore të cilat duhet të hulumtohen.

Sadudin Berisha- se a duhet ta kemi një Muze Komunal apo Regjional për mua është ende e pa definuar, sepse janë disa prej dokumenteve këtu ku thuhet Muze Komunal, kurse në disa Regjional. Për këtë Muze sigurisht se ka nevojë Gjilani, por jo tash, por shumë më herët ka pasur nevojë. A do të duhej ta ketë sa më parë sigurisht se po?

E tërë kjo punë dhe ky vullnet i mirë që është të të gjithë pa përjashtim, së pari duhet ta ketë së pari një bazë ligjore për ndërtimin e një institucioni jashtëzakonisht të rëndësishëm për të kaluarën tonë historike. Deri më tani nuk e kemi ndonjë ligj mbi të cilën bazë do të duhej fillojë procedura për themelimin e një institucioni?

Së dyti nga dokumentet të cilat na janë ofruar shkruhet dhe thuhet qartë se: ky është një projekt për themelimin e Muzeut Regjional të Gjilanit me një vendim të KK-së, përkatësisht të kryetarit të Komunës. Shtohet pyetje a është Qendër Regjionale Gjilani? Gjilani është Qendër Regjionale, por Gjilani nuk mund të vendos asgjë pa vullnetin e komunave tjera të Gjilanit, pa pëlqimin e tyre dhe pa i zbatuar procedurat me ligj. Për këtë arsyeje kujtoj se ky dokument është i nevojshëm për t' u nxjerr është i detyrueshëm për t' i nxjerr, por patjetër duhet të kemi një bazë juridike se si duhet të themelohet? Se a do të duhej të jetë vetëm Gjilani si themelues i këtij Muzeu, apo të pyetët edhe vullneti i komunave tjera kjo mund të diskutohet?

Me ligjin për themelimin i cili do të duhej të jetë i miratuar do të duhej patjetër të përcaktohet nëse Komuna do të duhej të bëjë vetë Muze Komunal, nëse do të duhej të themelojnë Muze Regjional atë e përcakton krejtësisht një procedurë tjetër do të thotë ministria përgjegjëse për Kulturë, Rini dhe Sport, por jo të jetë ekskluzivisht vullneti i një KK. Për këtë arsyeje unë mendoj se ky është një vullnet i mirë, por i pa bazuar në ligj. Ne si KK do të duhej ta alarmojmë përmes kryetarit të Komunës, përfaqësuesve, përkatësisht kryesisë së Kuvendit te ministria përkatëse që të përshpejtohet procedura për nxjerrjen e ligjit të tillë dhe të paraqitet dëshira dhe nevoja e qytetarëve gjilanas dhe gjithë qytetarëve të Kosovës që të kenë institucionalisht të krijuar një muze. Për këtë arsyeje LDK, jo se nuk është për këtë çështje, por nuk mund të merr pjesë në miratimin e dokumenteve të cilat janë fiktive dhe të cilat nuk mund të krijojnë bazë juridike dhe nuk mund të krijojnë bazë ligjore.

Sokol Haziri- në emër të grupit politikë për AAK-në ne e mbështesim projektin dhe nismën dhe këtë e trajtojmë si çështje vërtetë e mirë, por që duhet pasur në konsideratë edhe vërejtjet që ti thanë kolegët e mi. I mbështesë të gjitha pa rezervë në mënyrë që të dalin një vendim i kompletuar në baza ligjore. Natyrisht se Regjioni i Gjilanit ka historinë e vetë dhe ajo histori do të duhej diku të jetë e sistemuar, prandaj e mbështesim këtë nismë me vërejtjet të cilat u dëgjuan dhe me vërejtjet që i kam unë lidhur me mjetet financiare dhe buxhetin e të cilat duhet të jenë të planifikuara mirë në mënyrë që të bëjmë një projekt i cili do të finalizohet dhe t' i ketë afatet kohore për realizim. Natyrisht që objekti që u përmend, pos Shkollës së Muzikës ka në Gjilan mjaft edhe objekte të tjera të cilat do ta lehtësonin koston financiare të këtij projekti.

Arianit Sllamniku- parimisht Gjilanit i ka munguar një institucion i tillë edhe pse këtu tentohet që të minimizohet pesha e Komunës së Gjilanit në regjion. Mirëpo determinues është, ka qenë është dhe do të jetë Komuna e Gjilanit si bazë e regjionit.

Ne kemi pasur rastin konkret që nuk kemi pasur nevojë për miratim të nevojave tjera për shembull, Spitalin Regjional të Gjilanit ose gjykatën. Kështu që ma merr mendja që nuk është mirë t' i minimizohet pesha dhe rëndësia e Komunës sonë.

E dyta mendoj se ky vendim duhet të kalojë sot kështu siç është dhe e treta tri objektet të cilat janë përmendur në propozim për vetë faktin se edhe dislokimi i Sahat Kullës është bërë nga origjina e vendit për shkak të mos hapësirës në vendin ku ka qenë në mes ish objektit të TMK-së dhe Shtëpisë së mallrave, unë mendoj se propozimi i tretë të selia e LDK-së do të ishte propozimi më i mirë për rrumbullakimin e një territori si Qendër Monumentale e regjionit ku do ta epte madhësinë, sepse ka qenë edhe një objekt i cili i ka shërbyer edhe ushtrisë edhe pse tash shfrytëzohet që 12-13 vite jo mirë, pa qira e uzurpuar dhe kjo nuk i takon LDK-së kështu. Nëse kjo vendoset, atëherë selisë së PDK-së duhet shtruar një kusht për ta ndarë këtë seli për gjysmë me LDK-në. Ky është propozimi im dhe iu falënderoj për durim.

Sadudin Berisha- kolegu i im me sa duket nuk i përcjell drejt dhe mirë diskutime e parafolësve, në këtë rast ka të bëjë me diskutimin tim. Unë shumë qartë e kam thënë se Gjilanit i nevojitet një muze i Komunës apo një muze që e mbërthen të gjithë regjionin e saj. Gjilani është qendër dhe formale e regjionit. Gjilanit i nevojitet një muze dhe do ta bëjë këtë muze, por do ta bëjë në mënyrë ligjore me kompetencë dhe përgjegjësi. Nuk është në kompetencën e një KK, por edhe të Gjilanit si qendër regjionale të merr vendim për themelimin e një Muzeu Regjional.

Kolegu e mori shembull tipik Spitalin Regjional, por nuk është themelues i Spitalit Regjional, Komuna e Gjilanit, por është Ministria për Shëndetësi. Themelues i një Muzeu Regjional nesër do të jetë Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport ose do të përcaktohet një procedurë tjetër e shprehjes së vullnetit përmes përfaqësuesve të kuvendeve të komunave që e përfaqësojnë regjionin.

Sa i përket objektit ne kemi qenë jemi dhe do të jemi që objektet me rëndësi trashëgimore të ruhen maksimalisht. LDK-ja me kapitalin e vetë dhe mundësitë e veta ka bërë riparimin e objektit për të mos u shkatërruar. A është desh të jetë Sahat Kulla aty është non sens. Kur nuk kemi se çka të bëjmë tjetër, duhet vendos një Sahat Kullë aty.

Për këtë arsyeje nuk duhet të flasim me papërgjegjësi për gjërat të cilat janë me rëndësi për të kaluarën dhe të tashmen në Gjilan dhe veçmas për të ardhmen e saj.

Veton Nevzadi- unë i falënderoj anëtarët e Kuvendit për vërejtjet dhe sugjerimet të cilat na i dhanë dhe po i përgjigjem z. Sadudinit dhe po i them se Kosova e ka Ligjin për muze dhe ai ligj e parasheh si mund të themelohet një muze rajonal dhe një muze komunal. Është kompetencë e komunave për të shpreh vullnet të mirë dhe për të ofruar elaborat, për të pasur iniciativë në bazë të ligjit. Gjilani ka dimension më të gjer dhe unë e falënderoj Arianit Sllamnikun i cili e tha se të gjitha qendrat në Gjilan janë rajonale si Arkivi Rajonal, si Qendra për Trashëgimi Kulturore, prandaj ne nuk mund të kufizohemi dhe ta bëjmë një muze të qytetit, sepse Gjilani ka dimensione më të mëdha. Kompetencë e jona është për ta krijuar një elaborat, për ta pasur një vullnet të mirë, për t' i dhënë propozimet edhe atë jo vetëm për objektet, por edhe për ekipin punues profesional që do të punojë aty.

Qëllimi i jonë si Kuvend është për ta ofruar një opsion dhe mandej i vazhdojmë procedurat e tjera ligjore për themelimin të muzeut.

Lidhur me objektin për muze janë tri opsione dhe si objekt i parë është Shkolla e Muzikës për shkak të hapësirë që e posedon, opsioni i dytë është selia e kryetarit të Komunës dhe opsioni i tretë është selia e LDK-së e për të cilat propozime ju do të vendosni.

Sadudin Berisha- në elaborat thuhet: “qyteti i Gjilanit nuk ka muze”, kjo është e vërtetë. Mandej vazhdohet me nismën e kryetarit të Komunës emërohet komisioni për nismën e hartimit të projektit ideor për themelimin e Muzeut Rajonal në Gjilan.

Do të thotë janë marrë kompetencat e komunave të tjera! Urdhëroni dhe shikoni, interpretone nëse është ndryshe?

Në këtë elaborat ka aq shumë shkelje të ndryshme sa që është e pajustificueshme që të del një dokument i tillë. Unë më parë nuk desha të bëj polemikë, por më duhet të them se LDK, nuk e ka uzurpuar objektin, por LDK-ja ka validitet në shfrytëzim të atij objekti nga organet kompetente nga vitit 1999.

Izmi Zeka- unë mendoj se sa i përket pyetjes se a duhet ta ketë Gjilani një muze apo jo, kjo nuk duhet të diskutohet dhe nuk duhet të humbet kohë? Mënyra dhe detalet si do të themelohet dhe si do të duket i ka paraparë në projekt drejtori. Është bërë një punë disa mujore, është analizuar mirë dhe gjithmonë dikush duhet ta ketë një nismë.

Lidhur me ligjin e tha drejtori, kurse aspekti regjional është procedurë tjetër, por ne duhet ta marrim një vendim për t' i hapur rrugë themelimit të muzeut, sepse kjo nuk bëhet brenda një kohe të shkurtër. Ky është hapi i parë dhe nëse ka nevojë do të jemi në bashkëpunim edhe me kuvendet e tjera të niveli regjional.

Qemajl Mustafa- iu përshëndes të gjithëve dhe së pari po e theksoj se nuk kemi të bëjmë me komisionin siç po e interpreton Sadudini për themelimin e muzeut, por kemi të bëjmë me komisionin për hartimin e projektit ideor për themelimin.

Kemi të bëjmë me një komision i cili është kompetent dhe e drejtë e kryetarit të Komunës dhe zëvendësoni atë rajonal nëse është thënë aty me atë komunal. Këtë po e them, sepse u tha se kryetari i Komunës së Gjilanit i ka marrë kompetencat e kryetarëve

të komunave të tjera! Në fakt jo dhe le të jetë ajo komunal dhe gjithmonë në harmoni me ligjin për themelimin e muzeve në hapësirën e Kosovës edhe me rregullativën që e prodhon Qeveria, gjegjësisht Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport. Ideja ka qenë që të hartojmë një projekt dhe në takimet e para iu kam thënë që projekti mos të jetë futuristikë, që të mos jetë një projekt në “qiell ose hava” të them ashtu, por të jetë një projekt realistë, një projekt i cili përkon me realitetin e Komunës së Gjilanit dhe të rajonit edhe sa i përket mundësive hapësinore dhe mundësive financiare për stafin, për atë strukturë minimale e cila do të duhej për ta filluar punën në këtë muze.

Ideja ka qenë që ne ta hartojmë një projekt i cili përkon me realitetin sot dhe me një parashikim për disa vite të ardhshme se si mund të funksionojë ky muze dhe të krijojmë kushte minimale hapësinore dhe një strukturë të vogël dhe për fillim ndoshta vetëm një njeri i cili do të përkujdeset për eksponatet që vendosen aty.

Nuk e kemi filluar përmendësh duhet ta dini, sepse e kemi konsultuar Muzeun e Kosovës, Trashëgiminë Historike në Gjilan dhe në Ministri dhe na është thënë se kjo anë ka mjaft fakte dhe ka mjaft material i cili mund të sistemohet në muze dhe të pasurohet në vazhdimësi. Kjo duhet të merret me zemërgjerësi, do të thotë një vendim për një nismë për themelim të një Muzeu Komunal.

Arianit Sllamniku- unë mendoj se dhe pse dokumenti është në punim (drejtim e sipër), kemi mundësi për të paraparë që në dokument duhet të jenë të përfshira edhe pjesët e Luginës së Preshevës, komunave të asaj ane, për shkak të anës gravitacionale për ato komuna është dhe do të jetë Gjilani si komunë. Unë mendoj se nuk duhet anashkaluar edhe atë pjesë dhe patjetër duhet të inkorporohen në këtë projekt këto komuna si projekt regjional. Duhet ta marrim parasysh edhe këtë vërejtje dhe ta inkorporojmë në dokument.

Nevzad Rushiti- pasi që i jam anëtarë i Komitetit për Pronë po e ndiej një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe për të mos ia dhënë një përgjigje Arianitit. Ajo përgjigje është se nuk duhet në Kuvend ta thotë atë çka nuk është!

Do të thotë LDK-ja nuk e ka uzurpuar atë objekt aty, prandaj duhet që ta tërheq fjalën, sepse është fjalë publike dhe nuk duhet të flasë para opinionit kështu!

Izmi Zeka – nuk pati debatues të tjerë për këtë pikë të rendit të punës dhe kryesuesi kërkon që të deklarohen se kush është për aprovim të pikës 1 të rendit të punës?

Aprovohet pika 1 e rendit të punës: Propozim-projekti për themelimin e Muzeut të Komunës, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 11 ishin kundër.

Bahrie Veseli- mua më vjen keq, por z. Sami Hoxha është emëruar drejtori në Gjimnazin “Zenel Hajdini”, prandaj nuk ka të drejtë vote në këtë Kuvend!

Ju duhet ta dini vetë këtë dhe mos lejoni që ta shkelni ligjin!

Qemajl Mustafa- është e vërtetë nuk ka të drejtë, prandaj sekretaria duhet ta numëroj një votë më pak.

Pas vërejtjes nga ana kryetarit, konsiderohet se pika 1 e rendit të punës është aprovuar me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 11 ishin kundër.

2. Propozim –vendimi për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për studentë të dalluar

Bujar Nevzadi- sa i përket kësaj pike për ndarje të bursave dhe shpërblimeve, ne si drejtori dhe Komiteti i Arsimit në mbledhjen e fundit i kanë rekomanduar këtë propozim KK-së: në vitin e kaluar i kemi ndarë 40 bursa në vlerë prej 60 €, 30 bursa në vlerë prej 40 € dhe 20 shpërblime me nga 200€.

Këtë vit i kemi propozuar edhe 10 bursa me nga 60€, do të thotë e kemi propozimin për 80 bursa dhe 20 shpërblime. Po ashtu iu njoftoj se iu kemi mbet borxh edhe 30% studentëve nga viti i kaluar, por kjo pagesë do të bëhet për të gjithë studentët e vitit të kaluar deri në fund të muajit.

Sadudin Berisha- ne e mbështesim një projekt-vendim të tillë për ndarjen e 80 bursave, por e kam një vërejtje që kujtoj se është e pranueshme prej të gjithëve. Kujtoj se Gjilani nuk ka komoditet aq të lartë për të ndarë 80 bursa për të gjitha profilet dhe të gjitha degët në të cilat studiojnë studentët tanë. Do të duhej të jetë një nga pikat e këtij vendimi, se cilat profile (degë), kanë prioritet për ndarjen e bursave? Cilat fusha dhe cilat janë nevojat më me prioritet për Komunën e Gjilanit si kuadër deficitar?

Të gjitha profilet janë të nevojshme, por kur kemi ekonomistë dhe juristë në Entin për Punësim duke pritur për vend të punës dhe na mungojnë kuadro deficitare, kujtoj se atyre kuadrove duhet t' i ndahet bursa, sepse është një stimulim i veçantë.

Ne e kemi vendimin për ndarjen e 80 bursave, për pa u ditur se cilat degë të fakulteteve duhet të jenë me përparësi. Do të duhet të precizohen një mori kriteresh për të dal një vendim i fuqishëm dhe i pranueshëm prej të gjithë qytetarëve. Në këtë rast mund të manipulohet dhe t' i epet bursa studentëve të cilët jo që nuk kanë nevojë, por mund t' i lëmë anash studentët të cilët kanë nevojë edhe më të madhe.

Kërkesa jonë është që të precizohet saktësisht se cilat profile të studimeve do të kenë përparësi.

Shkëlqim Latifi – mua më vjen keq nga Sadudini, sepse përfaqësues të grupit të tij në Komitet është Bahrie Veseli dhe Sarandë Bllaca dhe këtu nuk ka manipulim dhe nuk kemi nevojë për ta keqpërdor foltoren. Kriteret i kemi miratuar vitin e kaluar unanimisht, por të njëjtat i kemi korrigjuar edhe këtë vit. Gjatë korrigjimit vetëm një kriter e kemi heq me pajtimin e të gjithëve dhe i kemi debatuar në veçanti edhe drejtimet deficitare. Nuk je i informuar, duhet të bashkëpunosh me grupin tënd, sepse iu kemi dhënë prioritet drejtimet të mjekësisë dhe elektros, por nuk kemi pasur mundësi t' i anashkalojmë as drejtimet e tjera., prandaj në Komitetin e Arsimit unanimisht kanë kaluar kriteret për ndarjen e bursave.

Sami Hoxha- komisioni që ka punuar për ndarjen e bursave gjithherë ka punuar në pajtim me kriteret dhe asnjëherë nuk ka bërë tejkallime, sepse më duket se z. Sadudini ia dhe një kahe kësaj çështje, jo ashtu si duhet punës së më parme! Do të thotë ka punuar në përputhje me kriteret që janë përcaktuar nga KPF, Komiteti për Arsim dhe Drejtorisë së Arsimit dhe të cilat kanë qenë të miratuara në KK.

Sadudin Berisha- pjesë përbërëse e këtij vendimi duhet të jenë të precizuara se cilave profile do të duhej t' i ndahet bursa. Unë në fund të diskutimit e thash se nëse kanë ekzistuar dhe ekzistojnë do të duhet të jenë këtu! Kërkoj falje nëse kanë ekzistuar, por duhet të jenë pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe duhet të thuhet se cilat profile kanë prioritet.

Bahrie Veseli- ashtu si e tha edhe kryesuesi i Komitetit ne jemi marrë vesh që kriteret të cilat kanë qenë edhe vitin e kaluar të precizuara të jenë edhe këtë vit, por kemi marrë obligim që të punojmë në mënyrë të sinqertë dhe t' i respektojmë ato kriteret të cilat i kemi miratuar dhe me prioritet e kemi thënë se janë shkencat kompjuterike dhe jo mjekësia, sepse mjekë në Gjilan kemi edhe të pa punë, prandaj e kemi thënë shkencat kompjuterike dhe fakultet matematikore. Ndoshta në vendim nuk janë theksuar këto gjëra, por ne në mënyrë unanime jemi pajtuar që të punojmë kështu.

Sokol Haziri- unë vetëm po e deklaroj mbështetjen e plotë që AAK ia jep këtij vendimi i cili ndoshta ka ndonjë mungesë përsosmërie, por jeta dhe procesi është i tillë dhe çdo cent që ndahet për shkollimin e të rinjve gjilanas ne e mbështesim. Është komisioni i cili do të bëjë punën konkrete për këtë çështje dhe me sa e vërejta unë ishte një komision gjithëpërfshirës dhe nëse vendosin për të punuar drejtë le të punojnë, por nëse nuk punojnë drejtë, atëherë bie përgjegjësia atyre.

Shkëlqim Latifi- është e vërtetë se nuk është cek në vendim, por transkripti i komitetit ekziston dhe ne si komitet i kemi besuar komisionit të Komunës që e ka bërë përzgjedhjen, sepse ai komision nxirret prej Kuvendit dhe i përfaqëson të gjitha partitë politike dhe kem menduar se nuk do të ketë dilema. Mirëpo nëse ka nevojë ne do ta plotësojmë dhe si çështje e dytë është se ne si komitet duke e ditur gjendjen financiare të Komunës e cila nuk ka mjete, për ndryshe vullneti i komiteti ka qenë që të rritet numri i bursave në 100, sepse është Dardana e cila i jep 100 bursa, por ne këtë vit e kemi rrit numrin vetëm për 10 bursa dhe unë publikisht e shfrytëzoj rastin ta falënderoj edhe Ridvan Asllanin i cila vullnetarisht ka shpreh dëshirën që t' i ndaj 10 bursa për studentët të cilët studiojnë në Prishtinë. Unë e shfrytëzoj rastin që edhe dhuruesit e tjerë ta mbështesin këtë nismë, kriteret janë dhe t' i ndihmojmë studentëve tanë, sepse kemi nevojë për të investuar në dije dhe i ftoj studentët e Gjilanit që të konkurrojnë për ndarje të bursave.

Izmi Zeka- e mira e kësaj është se ne po ndajmë bursa për çdo vit dhe kriteret ekzistojnë dhe besoj se ndarja e bursave do të bëhet për ata që e meritojnë. Ju lus që të deklaroheni se kush h është për aprovim të pikës 2 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Propozim –vendimi për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për studentë të dalluar, me 31 vota të anëtarëve të Kuvendit, nuk kishte kundër dhe abstenime.

3. Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për studentë të dalluar

Sadudin Berisha- ne vetëm e konfirmojmë kandidaturën e anëtarit të kaluar dhe ai ka qenë Rashit Sahiti i cili edhe këtë vit do të jetë anëtar i këtij komisioni.

Izmi Zeka- secila parti ashtu si e ka në vendim e dërgon kandidatin, ia dërgon sekretarisë dhe komisioni pastaj kompletohet.

Sokol Haziri- edhe ne e konfirmojmë kandidatin e mëparshëm për këtë komision e cila ka qenë Dritë Ismajli dhe të cilën e propozojmë edhe këtë vit.

Izmi Zeka- edhe unë në emër të grupit të PDK-së propozoj që të mbetet ai që ka qenë

Izmi Zeka- Kush është për aprovim të pikës 3 të rendit të punës?

Aprovohet pika 3 e rendit të punës: Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për studentë të dalluar, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në seancë.

4. Propozim vendimi për emërimin e Komisionit për Përcaktimin e Listës së lokacioneve dhe hapësirave publike për vendosjen e Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve dhe Simboleve, brenda territorit të Komunës së Gjilanit,

Izmi Zeka – në KPF, ne këtë çështje e kemi debatuar dhe jemi dakorduar që komisioni të jetë në këtë përbërje: 2 (dy) PDK, 2 (dy) LDK, 1 (një) AAK, 1 (një) AKR dhe 1 (një) G-3. Nëse nuk i keni dërguar emrat deri më tash sa më parë i dërgoni në sekretari dhe prej kohës kur merret vendimi ky komision e fillon punën i cili komision e posedon edhe rregulloren të cilën e kemi aprovuar në KK.

Sokol Haziri- unë pajtohem me atë që ta mbështesim këtë propozim, me të vetmen çështje që do të dëshiroj që ta diskutojmë pak më gjerësisht dhe mendoj t' i shtohet edhe një fjali këtij teksti të formuluar në këtë komision. Kjo ka të bëjë me krijimin e një hapësire ndoshta të veçantë tek varrezat e qytetarëve për njerëzit që kanë merita të veçanta. Do të ishte mirë që t' i shtohet edhe një fjali e vetme dhe ky komision krahas tërë këtij aktiviteti që përshkruhet në këtë vendim të ketë edhe këtë çështje. Nuk e di si janë mundësitë teknike, por unë në shumë vende i dëgjoj qytetarët se kanë interesime që njerëzit që kanë kontribute të veçanta të jetë një vend i përcaktuar për ata njerëz. Nuk mund të gjithë të varrosen te Kodra e Dëshmorëve, por të jetë diçka në mes dëshmorëve dhe qytetarëve të rëndomtë.

Izmi Zeka- kjo çështje është debatuar kur është debatuar për sistemimin e Varrezave të Dëshmorëve, por ka mbetur që ai këshill të takohet edhe njëherë dhe të propozojë një mundësi se si të bëjë zgjidhje?

Qemajl Mustafa- unë iu lus që sa më parë ta kompletoni këtë komision me të cilin kemi pas filluar ndoshta dy vite më parë. Mirëpo ky komision të jetë sa më profesional i mundshëm, kurse ne politikisht i mbështesim në mënyrë që ta bëjnë punën e vetë. Unë pajtohem me Sokolin, sepse për atë kemi debatuar te projekti i Qendrës Memoriale i cili është një projekt me një hapësirë prej 5 hektarëve.

Aty është menduar se përveç Varrezave të Dëshmorëve tek ajo hapësira që po shihet aty të jetë një lokacion në fazën e ardhshme një lokacion i përcaktuar për veteranët, për njerëzit merituar për sakrificën për liri. Mirëpo ajo duhet të jetë e profilizuar sa i përket lëvizjes, luftës, sakrificës, burgut për liri.

Ndërkaq te këto varrezat civile po e them të qytetarisë së Komunës do të duhej të jetë një hapësirë e veçantë, pajtohem, por problemi qëndron se nuk kemi vendos kritere dhe ato kritere duhet të vendosen në të gjitha fushat e jetës për sanksionim të atyre që janë të merituar. Duhet të dihet se secili njeri dhe secila familja do të këmbëngulte për t' i varros familjarët e tyre, apo pjesëtarët e shoqatave të tyre në atë pjesën e merituar. Po nuk vendosëm kritere të qarta do të krijohej një kaos, por dalëngadalë gjërat po kthjellën, sepse tash është Ligji për sanksionim të meritës së veteranëve të luftës dhe ky ligj do të sqarojë shumëçka.

Problem do të kemi te sanksionimi i meritave te të merituarit do të shkojnë punëtorët e merituar në arsim, punëtorët e merituar shoqëror e politik, ata të shëndetësisë, në kulturë, në sport, prandaj duhet të krijojmë normë për atë çështje.

Unë pajtohem që ashtu duhet të jetë në një lokacion të posaçëm të varrezave do të ekzistojë një hapësirë e veçantë për njerëzit e spikatur e të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë për shoqëri. Mirëpo kriteret duhet t' i bëjmë me kohë, sepse në të kundërtën nuk do të dihet kush kë po e varros në atë hapësirë!

Izmi Zeka- kjo çështje duhet t' i mbetet edhe Komisionit për akte normative dhe komisioneve tjera përkatëse që ta definojnë një rregullore të veçantë, sepse për pa pasur kritere nuk do të mund të marrim ndonjë qëndrim.

Unë jam që ta aprovojmë këtë propozim, por iu lus edhe njëherë që t' i dërgoni njerëzit profesionistë. Ju lus që këta emra t' i dërgoni sa më urgjentisht, pastaj e fillojmë punën.

Ju lus të deklaroheni se kush është për aprovim të pikës së 4 të rendit të punës?

Aprovohet pika 4 e rendit të punës: Propozim vendimi për emërimin e Komisionit për Përcaktimin e Listës së lokacioneve dhe hapësirave publike për vendosjen e Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve dhe Simboleve, brenda territorit të Komunës së Gjilanit, me 28 vota të anëtarëve të Kuvendit, nuk pati kundër dhe abstenime

5. Propozim vendimi për emërimin e Këshillit Komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë,

Izmi Zeka- po ashtu edhe në KPF jemi pajtuar që përbërja e komisionit të jetë e njëjtë për nga numri i grupimeve politike si ishte më parë në komisionin për vendosjen e busteve, përmendoreve dhe shtatoreve, por natyrisht të dy këshillave i duhen njerëzit

shumë profesionistë. Të keni konsideratë t' i propozoni njerëzit të cilët janë të përgatitur shumë profesionalistë, sepse nuk është lehtë të bëhet një vlerësim i tillë.

Sadudin Berisha-ne në parim e kemi mbështet një projekt –vendim të tillë dhe pika 4 dhe 5 pak a shumë janë të ndërlidhura dhe a do të duhej të bëhej kjo sa më parë do të ishte mirë, por me të vërtetë duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe nuk guxojmë ta bëjmë një punë sa për të thënë, sepse mund të krijohen pakënaqësi të cilat mund të reflektojnë jashtëzakonisht shumë negativisht para opinionit publik të Gjilanit.

Duke i ditur përgjegjësitë dhe obligimet që i ka Presidenti, Qeveria dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës për këtë fushë, prandaj ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm në përfshirjen e kompetencave dhe në anën tjetër në përcaktimin e këtyre çështjeve.

Ne do të jemi pjesë përbërëse e këtij Komisioni me njerëzit të cilët më së shumti mund të japin kontributin e tyre, por paraprakisht do të duhej të bëhen shumë e shumë punë të cilat vlejnë për të punuar ky Komision

Izmi Zeka- iu falënderoj për kontributin që u dha lidhur me këtë pikë, prandaj iu lus që të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij propozimi?

Aprovohet pika 5 e rendit të punës : Propozim vendimi për emërimin e Këshillit Komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në këtë seancë.

Izmi Zeka- në të ndryshme ishte edhe një informatë plotësuese e drejtorit të Administratës së Përgjithshme, por drejtori për shkaqe shëndetësore nuk është i pranishëm në këtë seancë, prandaj kjo informatë mbetet për seancën e radhës.

Ju falënderoj për kontributin e dhënë dhe mirupafshim në seancën e radhës!

Me këto debate seanca i përfundoi punimet në ora 12.30 min.

Procesmbajtësi

Sali Hasani

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA